



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 1970/23 Prot.

Divjakë, më 24.03.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 33 Datë 24/03/2026

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 85, DATË 29.12.2025”

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, te Kreut II, neni 4 pika d te Kreut IX, neni 54, neni 64 pika „c” dhe „j” te Kreut X, Ligji nr. 9901 Datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar; ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, VKM nr. 480, datë 31.05.2017 "Për miratimin e rregullores së menaxhimit të integruar të mbetjeve", Ligji Nr. 93/2015 "Për Turizmin" i ndryshuar, në vendimin e Keshillit Bashkiak Nr. 85, datë 29.12.2025 "Për transferimin e disa funksioneve nga aparati i Bashkisë Divjakë në shoqërinë e krijuar me VKB Nr. 23, datë 24.04.2025 "Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Rrjela" shpk dhe miratimin e statutit dhe aktit të themelimit", - i propozojmë Keshillit të Bashkisë Divjakë që në mbledhjen e datës 30/03/2026,

TË MIRATOJË:

1. Shtimin në pikën 1, të VKB, Nr. 85, datë 29.12.2025 të germës d) ,si më poshte;
Pika 1 është,- "Transferimin e disa funksioneve nga Aparati i Bashkisë Divjakë dhe Agjensia e Shërbimeve Komunale në Shoqërinë e krijuar me Vkb Nr 23 datë 24.04.2025 , Rrjela Shpk me nipt-M54721402H"

- a) Grumbullim dhe transport i mbetjeve
- b) Administrimin e varkave dhe kulla 360 °
- c) Administrimin e tregjeve e lira ,

Shtohet germa d) - Organizimin dhe administrimin e eventeve kulturore, ngjarjeve artistike

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e kulturës, sportit dhe turizmit dhe Drejtoritë përkatëse në Bashki.

Per Drejtorine Juridike, prokurimeve publike dhe menaxhimit te asetëve

Andi Bullari

Per Drejtorine e Finances dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola

Per Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Dritan Qose

KRYETARI
JOSIE GORREA

